

## Njoftim

Regjistrimi online, për Raundin 1 – Faza 1, mund të kryhet nga data 04 Shtator 2015 deri më datë 09 Shtator 2015, nga ora 08:00, deri në orën 18:00, sipas procedurave të përshkruara në udhëzimin teknik, të publikuar në faqen: [www.akp.gov.al](http://www.akp.gov.al).

Sjellim në vëmendjen tuaj opsionet e regjistrimit si më poshtë:

1. Nëse doni të vazhdoni konkurrimin për preferencat më të larta, zgjidhni (klikoni) opsionin: **“Vazhdoj konkurrimin për një preferencë më të lartë”** dhe klikoni butonin: **“Ruaj”**  
Pasi të klikoni te butoni **“Ruaj”**, do t’ju shfaqet mesazhi **“Veprimi u krye me sukses”** dhe pas kësaj mund të dilni nga faqja dhe të mbyllni browserin e internetit.
2. Nëse jeni shpallur fitues te një preferencë e ndryshme nga preferenca e parë dhe dëshironi të regjistroheni në mënyrë përfundimtare aty, pra të mos vazhdoni konkurrimin për një preferencë më të lartë, duhet të zgjidhni (klikoni) opsionin: **“Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar”** dhe më pas të klikoni tek butoni: **“Ruaj”**.

**Kujdes: Nëse keni vendosur përfundimisht ta ndërprisni garën, veprimi i mësipërm duhet të kryhet përpara se te dilni nga faqja. Në rast të kundërt, regjistrimi juaj bëhet në mënyrë automatike nga sistemi me opsionin “Vazhdoj konkurrimin për një preferencë më të lartë”.**

3. **Kujdes! Veprimi i regjistrimit on-line lejohet të kryhet vetëm një herë.**

Kujdes : Respektoni afatet e regjistrimit që të mos humbisni të drejtën e vazhdimin të studimeve.